



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkiv Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 1957
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 2
Data/Datum/Date: 12.05.2023 PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 12.05.2023

Ref. KM-189/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.7/ 01 mars 2019, Prishtinë), nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.13/1 shtator 2011), nenin 13 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2014 për caktimin e kriterëve për marrjen e mostrave, analizën e mushtit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera si dhe vlerësimin organoleptikë të verës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4, nenin 15 Shtojcën 11 të Rregullores (QRK)-NR.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**V E N D I M**

**Për emërimin e Komisionit profesional për vlerësimin zyrtar të verës nga vjelja e vitit 2022**

1. Emërohet Komisioni, në përbërje prej shtatë (7) anëtarësh:

- 1.1. Sadik Korenica, kryesues,
- 1.2. Tasim Bajrami, sekretar,
- 1.3. Fejzullah Berisha, anëtar,
- 1.4. Eshref Kasapi, anëtar,
- 1.5. Bejtullah Haxhimurati, anëtar ,
- 1.6. Nesim Morina, anëtar, dhe
- 1.7. Ylber Kuqi, anëtar.

2. Nëse ndonjëri anëtar i komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi mungon, atëherë anëtar rezervë caktohet Visar Hajrullaga.

3. Komisioni obligohet të bëjë vlerësimin zyrtar të verërave të prodhuara në Republikën e Kosovës nga vjelja e vitit 2022, duke u bazuar në nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për Verërat, nenin 21, paragrafi 1 nën paragrafët 1.1., 1.2. 1.3,

1.4 dhe 1.5 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.04/2014 për caktimin e kritereve për marrjen e mostrave, analizën e mushtit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera si dhe vlerësimin organoleptikë të verës.

4. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi obligohet të bëjë vlerësimin zyrtar të verës nga vjelja e vitit 2022 të mostrave (136 tipe të verës) me datën 18, 19 dhe 23 Maj 2023, duke filluar në ora 10<sup>00</sup> në Zyrat e Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë në Rahovec.

5. Anëtarët e Komisionit nga pika 1 të këtij vendimi për punën e kryer do të kompensohen veç e veç nga pesëdhjetë euro (50€) në ditë për një anëtar, për tri ditë të vlerësimit nga 150 € për secilin anëtar nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve nga kodi organizativ Nr.45800 Departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë.

6. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi ka për detyrë që të hartoj raport të detajuar pune me shkrim për ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

7. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij Vendimi.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi t'i dërgohet:*

- *Anëtarëve;*
- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm; dhe*
- *Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë, dhe*
- *Arkivit.*

**Faton Peci**  
  
**Ministër**

